



**UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY**  
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë  
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. nr. 011534 Dt. 16/03 /2023

Në bazë të nenit 48 paragrafi 1, nën paragrafi 1.9 dhe nenit 100 paragrafi 1 dhe 2, të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan, për organizimin e studimeve master, Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan, në mbledhjen e XXXVI, mbajtur më 03.10.2022, miratoi këtë rregullore:

## **RREGULLORE E STUDIMEVE MASTER NË FAKULTETIN E EDUKIMIT**

### **Dispozitat e përgjithshme**

#### **Neni 1**

Me këtë Rregullore të studimeve master në Fakultetin e Edukimit (në tekstin e mëtejshëm - Rregullore) përcaktohen kriteret e posaçme të organizimit të studimeve të nivelit master në Fakultetin e Edukimit (shpallja e konkursit, organizimi dhe llojet e studimeve, kushtet e pranimit dhe të regjistrimit të studentëve, kohëzgjatja e studimeve, të drejtat dhe obligimet e studentëve, organizimi i mësimit dhe i provimeve, përcaktimi dhe mënyra e punimit dhe e mbrojtjes së temës së masterit, si dhe çështje të tjera që lidhen me këto studime deri në kryerjen e tyre).

### **Organizimi dhe llojet e studimeve**

#### **Neni 2**

1. Fakulteti i Edukimit organizon studime të rregullta të nivelit master për fitimin e gradës akademike në programet e përcaktuara të studimeve master.
2. Fakulteti i Edukimit mund të organizojë studime master edhe në bashkëpunim me fakultetet e tjera të universiteteve publike të vendit, mbi bazën e programeve të përbashkëta të studimeve dhe memorandumeve për partneritet.

#### **Neni 3**

1. Studimet e nivelit master kanë të drejtë t'i regjistrojnë të gjithë kandidatët, të cilët i kanë kryer studimet themelore (bachelor) në vlerë prej 240 ECTS apo 180 ECTS (për programet master prej 120 ECTS).
2. Studimet e nivelit master kanë të drejtë t'i regjistrojnë të gjithë kandidatët, të cilët i plotësojnë kushtet dhe kërkesat e programit përkatës sipas specifikave të programit të akredituar.
3. Në studimet master kanë të drejtë të regjistrohen edhe kandidatët, të cilët studimet themelore i kanë kryer jashtë vendit, diplomat e të cilëve janë njohur nga Ministria e Arsimit, e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në bazë të ligjit dhe rregulloreve në fuqi.

4. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet sipas kriterëve të përcaktuara nga Statuti i UKZ-së dhe sipas kushteve të specifikuara në programin e akredituar.

#### **Neni 4**

Studimet master përfundojnë me mbrojtjen e tezës së masterit në pajtim me programin e studimeve që mund të jetë në vlerë prej 60, 90 apo 120 ECTS.

#### **Neni 5**

1. Të drejtën e mësimdhënies në studimet master e ka personeli mësimor me thirrjet universitare: profesor i rregullt (prof. dr.), profesor i asocuar (prof. asoc. dr.) dhe profesor asistent (prof. ass. dr.), i cili i plotëson kushtet e parapara me Statutin e Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan. Të drejtën e mbështetjes së profesorit në procesin e mësimdhënies në nivelin master e kanë edhe asistentët, varësisht nga programi.
2. Në raste të caktuara për ndonjë lëndë mësimore mund të mbajnë mësim dy a më shumë mësimdhënës. Në rastet kur mësimin e mbajnë dy a më shumë mësimdhënës notat në SMU i vendos bartësi i lëndës.

#### **Neni 6**

1. Studimet master i udhëheq Këshilli i Fakultetit, në kuadër të të cilit implementohet programi i studimeve master.
2. Këshilli i Fakultetit mund ta zgjedh një shef të studimeve të masterit, me propozimin e dekanit.
3. Shefi i studimeve master duhet të jetë mësimdhënës i rregullt në Fakultetin e Edukimit.
4. Shefi i studimeve master, me mbështetjen e dekanit dhe të Këshillit të Fakultetit:
  - 4.1. Shqyrton ndarjen e lëndëve dhe mbulimin adekuat të kurseve me kuadrot përgjegjëse duke u bazuar në thirrjet dhe fushën e specializimit të personelit;
  - 4.2. Analizon fushëveprimtarinë e programit studimor, analizon planin e studimeve, sillabuset e lëndëve dhe mbarëvajtjen, si dhe raporton për nivelin e realizimit të përmbajtjeve sipas semestrave të programeve;
  - 4.3. Përgatit raportin e vetëvlerësimit dhe dokumentet e tjera të nevojshme për akreditim/riakreditim të programeve, të cilat kërkohen nga ZZHA.
  - 4.4. Përpilon raportin përmbledhës për vlerësimin e punës së programeve të studimit ndërmjet periudhave akredituese të studimeve në periudhën 3-vjeçare (MA);
  - 4.5. Shefi i studimeve master kryen edhe punë të tjera, sipas nevojës dhe kërkesës së dekanit të fakultetit.

#### **Neni 7**

Mësimi në studimet master realizohet në formë të ligjëratave, seminareve, ushtrimeve teorike, punës praktike dhe punës në terren, vizitave studimore, diskutimeve, konsultimeve profesionale dhe nëpërmjet punimeve të pavarura të studentëve.

#### **Neni 8**

##### **Kushtet e regjistrimit**

1. Fakulteti i Edukimit në Universitetin "Kadri Zeka" regjistron studentë në shkallën master, sipas programeve të akredituara.
2. Propozimin për regjistrimin e studentëve të rinj e jep Këshilli i Fakultetit dhe e miraton Senati.

3. Vendimin përfundimtar për shpalljen e konkursit publik e merr Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në bashkëpunim me MASHTI-n.

#### **Neni 9**

1. Përzgjedhjen e kandidatëve sipas nenit 3 (tre) të kësaj Rregulloreje e bën komisioni përkatës, i përbërë nga së paku 3 anëtarë, me propozimin e Këshillit të Fakulteti.
2. Komisioni duhet të jetë kompetent dhe profesional.
3. Kandidatët që nuk pranohen në studimet e nivelit master mund të bëjnë ankesë me shkrim në administratën e fakultetit, brenda dy ditësh të punës pas publikimit të rezultateve.

#### **Neni 10**

Vendimi përkitazi me kërkesat e studentëve merret në një afat prej dy ditësh pune, pas shqyrtimit të ankesave nga Komisioni i ankesave apo sipas afateve që ndryshe caktohet me konkurs.

#### **Neni 11**

Regjistrimi i studentëve në semestrin e parë të studimeve master bëhet në Zyrën e IT-së në UKZ, kurse pajisja e studentit me ID kartelë bëhet në shërbimi e studentëve të studimeve master.

#### **Neni 12**

##### **Ndërrimi i programit / drejtimit të studimeve**

Për ndërrimin e programit të studimeve ose për transferimin e studentit prej ndonjë fakulteti tjetër të UKZ-së, ose prej ndonjë universiteti tjetër të akredituar brenda a jashtë vendit, vlejnjë dispozitat e parapara me Statutin e Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan.

#### **Neni 13**

##### **Kohëzgjatja e studimeve**

1. Studimet e nivelit master zgjasin 2 (dy), 3 (tre), përkatësisht 4 (katër) semestra, varësisht sipas akreditimit të programit. Me përfundimin e këtyre studimeve duhet të arrihen 60, 90 ose 120 ECTS, varësisht nga programi i studimeve.
2. Në përputhje me kushtet e përcaktuara me Statutin e UKZ-së, studenti e ruan statusin e studentit të rregullt edhe për së paku 2 (dy), 3 (tre) apo 4 (katër) semestra shtesë, varësisht nga kohëzgjatja e programeve.
3. Semestrat mësimorë fillojnë dhe mbarojnë sipas dispozitave të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan.
4. Mësimi në studimet master zhvillohet gjatë 15 javësh brenda një semestri.

#### **Neni 14**

##### **Kushtet për fitimin dhe humbjen e statusit të studentit**

1. Personi i regjistruar në Fakultetin e Edukimit e ka statusin e studentit të rregullt.
2. Statusi i studentit dëshkohet me ID- kartelë ose me ndonjë dokument ekuivalent.
3. Në rast të humbjes së ID- kartelës, me lejen e Dekanit të fakultetit, studentit i jepet "ID- kartela tjetër. Kërkesës për ID kartelë të re duhet t'i bashkëngjitet dëshmia se ID- kartela paraprake është shpallur e pavlefshme dhe se është bërë pagesa sipas kushteve të përcaktuara në SMU.
4. Kushtet për fitimin dhe humbjen e statusit të studentit janë rregulluar me Statutin e Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan.

5. Këshilli i Fakultetit, me propozimin e Komisionit disiplinor, i përjashton nga fakulteti përkohësisht ose përgjithmonë studentët, të cilët i shkelin rregullat e përcaktuara me Rregulloren për procedurën disiplinore të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan.
6. Humbja e statusit të studentit rregullohet me Statutin e Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan.

#### **Neni 15**

#### **Të drejtat dhe obligimet e studentëve**

Përcaktimi i përgjegjësisë disiplinore të studentëve rregullohet me Rregulloren për Procedurën Disiplinore të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan.

#### **Neni 16**

1. Studentët kanë të drejtë të ankohen kundër vendimit të shqiptuar nga organet e fakultetit që kanë të bëjnë me të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre.
2. Ankesat e tilla i dorëzohen Këshillit të Fakultetit nëpërmjet arkivit të fakultetit brenda 8 ditësh të punës pas shpalljes së vendimit.
3. Komisioni është i obliguar t'ia dorëzojë raportin për vendimin e shqiptuar dekanit të fakultetit, brenda 7 ditësh të punës, pas shqyrtimit të ankesës. Vendimin përfundimtar, dekani e dërgon për aprovim në Këshillin e Fakultetit.
4. Ankesa rreth vendimit të shkallës së parë vendoset nga Senati i Universitetit.

#### **Neni 17**

#### **Kushtet e regjistrimit të vitit**

Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka", me vendim të veçantë përcakton kushtet e regjistrimit të vitit vijues të studimeve në nivelin master.

#### **Neni 18**

#### **Organizimi i provimeve**

1. Studenti e fiton të drejtën t'i shtrohet provimit në një lëndë pasi t'i kryejë obligimet që parashihen me programin mësimor të studimeve master.
2. Provimet mbahen me shkrim, me gojë, ose me shkrim dhe me gojë. Kur provimi përbëhet nga pjesa me shkrim dhe me gojë, studenti mund të hyjë me gojë vetëm atëherë kur në pjesën me shkrim ka marrë notë pozitive.
3. Për përcaktimin e suksesit akademik të studentit mund të aplikohen edhe forma të tjera të vlerësimit, të përcaktuara në syllabuset e lëndëve përkatëse dhe në specifikat e programit të akredituar.
4. Në programet ku parashihet dhënia e provimeve diferenciale, studentët janë të obliguar që para se të hyjnë në provimet e rregullta t'i kryejnë provimet diferenciale.

#### **Neni 19**

Provimet në studimet master mbahen gjatë vitit akademik sipas afateve të lejuara me Statutin e UKZ-së dhe me udhëzime të Senatit të Universitetit.

#### **Neni 20**

1. Për suksesin e arritur në provim studentit vlerësohet me notën 10 (shkëlqyeshëm) deri në notën 6 (mjaftueshëm).

2. Nota evidentohet në SMU me numër të ID-kartelës dhe raporti në formë fizike dërgohet te Shërbimi i studentëve i Fakultetit, më së paku tre (3) e më largu pesë (5) ditë nga evidentimi i notave në SMU.
3. Raportet lëndore dhe fletëparaqitjet fizike të provimit i dërgohen Shërbimit për student/zyrtarit përkatës, i cili më së paku 2 ditë të punës pas dorëzimit nga mësimdhënësi i lidh në koleksionin e raporteve të afatit përkatës dhe i vendos në librin amë dhe në dosjen e studentit.
4. Studenti që dështon ta kryejë provimin 3 afate detyrohet ta përsërisë dëgjimin e kursit përkatës, konform nenit 110 të Statutit të UKZ-së.

### **Neni 21**

Për studentët e pakënaqur me vlerësimin dhe notën e marrë në provim vlejné dispozitat e Statutit të UKZ-së.

### **Neni 22**

#### **Punimi i temës së masterit**

Studenti ka të drejtë të parashtojë kërkesë për lejimin e tezës master të propozuar, pasi t'i ketë kryer të gjitha obligimet e parapara me planin dhe programin mësimor. Si mentor potencial i studentit është mësimdhënësi në konsultim me të cilin studentit është përcaktuar për temën e punimit të masterit.

### **Neni 23**

1. Këshilli i Fakultetit e shqyrton kërkesën e studentit bashkë me projektin përkatës dhe merr vendim ta miratojë, ta kthejë për plotësim ose ta refuzojë atë.
2. Këshilli i Fakultetit shqyrton propozimprojektet e temave të diplomës master dhe propozon mentorët dhe anëtarët e Komisionit për vlerësimin e punimit të kryer të temës së diplomës master.
3. Këshilli i Fakultetit, bashkë me zyrtarin e studimeve master, mban evidencë për numrin e temave të diplomës të masterit, për të cilat një mësimdhënësi mund të jetë mentor gjatë një viti akademik.

### **Neni 24**

Punimi i masterit elaborohet individualisht nga studentit, duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimeve mund të zbatohen me sukses për zgjidhjen e problemeve kërkimore të fushës përkatëse shkencore.

### **Neni 25**

1. Kërkesa e kandidatit për punimin e tezës së masterit duhet të bëhet me shkrim.
2. Projekt-propozimi për temë masteri duhet të përmbajë elementet si në vijim:
  - 2.1. Titulli i temës,
  - 2.2. Arsyetimin e temës së propozuar,
  - 2.3. Qëllimin e studimit,
  - 2.4. Diskutimin e literaturës së shqyrtuar,
  - 2.5. Pyetjen e hulumtimit dhe hipotezën/at,
  - 2.6. Metodologjinë e studimit,
  - 2.7. Rezultatet e pritura të studimit,
  - 2.8. Referencat e literaturës së shqyrtuar,

2.9. Strukturën e temes.

3. Detajet, formati dhe proceset e planifikimit të projektpropozimit elaborohen në "Doracakun e tezës master", i cili miratohet nga Këshilli i Fakultetit si dokument plotësues për këtë rregullore.

#### Neni 26

1. Këshilli i Fakultetit e propozon Komisionin prej tre anëtarësh për vlerësimin e projektpropozimit të tezës së masterit.
2. Njëri nga anëtarët e Komisionit është mentori i kandidatit, i cili e udhëheq studentin gjatë realizimit të punimit të masterit.
3. Njëri nga dy anëtarët e tjerë të Komisionit vlerësues caktohet kryesues i Komisionit dhe i udhëheq procedurat e mbrojtjes së tezës së masterit.

#### Neni 27

Punimi i masterit përbën punim të pavarur profesional të kandidatit me anë të të cilit ai dëshmon që ka përvetësuar njohuri e dije dhe mund të parashtrijë e zgjidhë probleme e detyra profesionale-shkencore sipas udhëzimeve në doracakun për punimin e tezës së masterit.

#### Neni 28

1. Pas vendimit për lejimin e temës së propozuar nga Këshilli i Fakultetit, dorëshkrimi i punimit të masterit së bashku me kërkesën për vlerësimin e dorëshkrimit nga Komisioni vlerësues, duhet të dorëzohen më së voni 1 (një) vit nga data e lejimit.
2. Me kërkesën e arsyetuar me fakte të studentit dhe mentorit, Këshilli i Fakultetit mund të vendos shtyrjen e afatit për përfundimin e punimit të masterit edhe për më së shumti 6 (gjashtë) muaj.
3. Në qoftë se kandidati nuk e dorëzon punimin e përfunduar të tezës së masterit për vlerësim në afatin e caktuar me këtë nen, ai duhet ta rifillojë procedurën për lejimin e punimit të një teze të re, përkatësisht ta rikthejë statusin e studentit të rregullt në pajtim me nenet përkatëse të Statutit të UKZ-së.

#### Neni 29

1. Pas dorëzimit të tezës së kryer dhe kërkesës së kandidatit për vlerësim të dorëshkrimit, mentorit dhe secilit anëtar të Komisionit i dorëzohet nga një kopje e dorëshkrimit të punimit së bashku me vendimin për emërimin si anëtar i Komisionit për vlerësim të dorëshkrimit të tezës së kryer të punimit të masterit.
1. Komisioni për vlerësim është i obliguar që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit ta dorëzojë raportin e nënshkruar për miratim në Këshillin e Fakultetit.

#### Neni 30

1. Komisioni për vlerësimin e dorëshkrimit të tezës së masterit përbëhet prej tre anëtarësh.
2. Anëtarë të Komisionit duhet të jenë mësimdhënësit me thirrje të profesorit (profesor i rregullt, profesor i asociuar, profesor asistent), nga fusha e studimit të temës përkatëse dhe me përvojë akademike dhe shkencore në fushën e studimit të temës përkatëse.
3. Tezat e masterit që kanë karakter të didaktikës dhe pedagogjisë së fushës lëndore duhet të kenë së paku një anëtar të profilit të pedagogjisë, psikologjisë apo filozofisë varësisht nga natyra e temës.

### Neni 31

1. Pas raportit pozitiv të dorëzuar me shkrim nga anëtarët e Komisionit, raporti i nënshkruar së bashku me dorëshkrimin e punimit, në afat prej 15 ditësh pune, duhet të qëndrojë në diskutim publik në Sekretarinë, Bibliotekën dhe Arkivin e Fakultetit. I gjithë stafi akademik i fakultetit i pranon në formë elektronike të gjitha temat që vendosen në diskutim publik.
2. Pas skadimit të afatit të caktuar për diskutim publik, propozimi i Komisionit për vlerësim të dorëshkrimit, shqyrtohet dhe propozimi përfundimtar procedohet në Këshillin e Fakultetit, i cili merr vendim përfundimtar për raportin e Komisionit, vlefshmërinë e dorëshkrimit dhe lejimin e mbrojtjes publike.
3. Secili anëtar i Këshillit të Fakultetit të Edukimit pranon materialin në formë të shtypur në mbledhjen në të cilën shqyrtohet dhe miratohet dorëshkrimi i tezës së masterit. Në këtë rast, Këshilli i Fakultetit e aprovon, plotëson ose e formon rishtazi Komisionin prej tre anëtarësh (dhe një anëtar rezervë) për mbrojtjen publike të tezës së masterit.
4. Komisioni për mbrojtje publike formohet në përbërje të përcaktuar me nenin 29 të kësaj Rregulloreje, i cili në afatin jo më të shkurtër se pesë (5) ditë të punës organizon mbrojtjen publike të tezës së masterit.
5. Mbrojtjen publike të punimit të masterit e udhëheq kryetari i Komisionit. Kryetar i Komisionit nuk mund të jetë mentori.

### Neni 32

Në qoftë se punimi i kandidatit refuzohet nga Komisioni përkatës ose kandidati për shkaqe të tjera nuk e bën plotësimin e punimit në afatin sipas nenit paraprak, kandidati ka të drejtë që të paraqesë propozim me shkrim për titullin e ri të punimit të masterit.

Këtë mundësi kandidati mund ta shfrytëzojë vetëm edhe një herë.

### Neni 33

1. Në qoftë se Këshilli i Fakultetit me propozimin e Këshillit të Departamentit ia kthen kandidatit punimin për ta plotësuar, me atë rast mund ta zgjerojë Komisionin për vlerësimin e punimit të plotësuar. Kandidati duhet ta bëjë plotësimin e punimit të masterit më së largu në afat prej 6 (gjashtë) muajsh.
2. Kur Komisioni e pranon dorëshkrimin e punimit të plotësuar, është i obliguar që të hartojë raport të ri mbi vlerësimin e punimit dhe të njëjtin, nëpërmjet Këshillit të Departamentit, t'ia dërgojë Këshillit të Fakultetit në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të dorëshkrimit.

### Neni 34

1. Komisioni, në marrëveshje me kandidatin dhe me miratimin e departamentit, e cakton datën dhe vendin (sallën) e mbrojtjes publike të punimit.
2. Mbrojtja publike e punimit të mastrit duhet të bëhet brenda një afati jo më pas se 5 ditë dhe jo më shumë se 30 ditë nga dita e nxjerrjes së vendimit.

### Neni 35

1. Sekretariati i fakultetit, në konsultim me Komisionin e vlerësimit, shpall lajmërimin për mbrojtjen e punimit të masterit së paku 5 ditë para ditës së mbrojtjes.
2. Lajmërimi shpallet në tabelën e shpalljeve në Fakultet dhe në ueb-faqen e Fakultetit. Në lajmërim jepen të dhënat për kandidatin, tema e punimit, data, ora dhe salla e mbrojtjes publike.

3. “Doracaku i tezave master” dhe “Modeli i shkrimit të tezave master” janë pjesë plotësuese të kësaj Rregulloreje dhe miratohet nga Këshilli i Fakultetit për të rregulluar proceset dhe standardet e realizimit, vlerësimit dhe shkrimit të tezave master.

#### **Neni 36**

##### **Procedurat e mbrojtjes**

1. Mbrojtja e punimit të diplomës është publike dhe zhvillohet para Komisionit të përbërë nga tre anëtarë, duke respektuar rregulloren.
2. Komisioni mban procesverbalin mbi mbrojtjen me gojë të diplomës nga ana e kandidatit.
3. Kriteret e vlerësimit janë: cilësia e punimit të diplomës master, cilësia e ekspozesë dhe cilësia e përgjigjeve me gojë në pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Komisionit vlerësues. Secili nga anëtarët e Komisionit e bënë vlerësimin individualisht. Nota përfundimtare paraqet mesataren e vlerësimeve. Në rast të mospajtueshërisë ndërmjet mentorit dhe anëtarëve të tjerë të Komisionit (kryetarit dhe anëtarit), vlerësimi përfundimtar mbetet vlerësimi i bërë nga kryetari i Komisionit.
4. Notën e arritur në mbrojtje, Komisioni e shënon në procesverbal, në fletëparaqitje dhe në SMU.

#### **Neni 37**

1. Kryetari i Komisionit e hap seancën për mbrojtjen publike të punimit të masterit, paraqet të dhënat lidhur me procedurën e zhvilluar deri në nxjerrjen e vendimit për lejimin e mbrojtjes së punimit, si dhe paraqet të dhënat bibliografike të kandidatit.
2. Mentori e paraqet referatin e Komisionit për vlerësimin e punimit të tezës së masterit.
3. Kandidati nëpërmjet parashtesës së tij (përmbledhje e shkurtër dhe përmbajtësore e punimit), bën një prezentim jo më të gjatë se 30 minuta.

#### **Neni 38**

1. Vlerësimi i punimit dhe mbrojtjes së punimit të kandidatit bëhet me notë. Notat kaluese janë nga 6 deri 10.
2. Nota për të përshkruar nivelin e suksesit në provime:
  - 2.1. 10 (A) SHKËLQYESHËM – njohuri të shkëlqyeshme me vetëm disa gabime minore
  - 2.2. 9 (B) SHUMË MIRË – mbi mesataren standarde, por me disa gabime
  - 2.3. 8 (C) MIRË – rezultat në përgjithësi i mirë me disa gabime që vërehen
  - 2.4. 7 (D) KËNAQSHËM – mirë, por me mjaft gabime
  - 2.5. 6 (E) MJAFTON – rezultatet i plotësojnë kriteret minimale
3. Fletëparaqitjet fizike dhe raporti i provimeve të nxjerra nga SMU, i dërgohen zyrtarit të Shërbimeve të studentëve, i cili më së voni dy ditë pas kryerjes së provimit dhe pranimit të raportit nga mësimdhënësit, i kompletton dhe i lidh si libër të afatit të provimeve, kurse notat i regjistron në librin amëz dhe në dosjen e studentit.

#### **Neni 39**

1. Komisioni, duke marrë parasysh përmbajtjen e punimit, autorësinë e tij dhe përgjigjet e kandidatit të pyetjeve të anëtarëve të Komisionit, merr vendim përfundimtar për vlerësimin e punimit. Kryetari i Komisionit e përmbyll procedurën e mbrojtjes dhe e fton Komisionin që të tërhiqet jashtë sallës për ta bërë vlerësimin dhe për të marrë vendimin përfundimtar
2. Vlerësimi i tezës së masterit bëhet me notë
3. Vendimi i Komisionit shpallet publikisht para auditorit.



#### Neni 40

1. Kandidati ka mbrojtur me sukses punimin e masterit në qoftë se vendimi dhe vlerësimi pozitiv i mbrojtjes së punimit janë bërë njëzëri ose nga shumica e anëtarëve të Komisionit.
2. Nëse kandidati nuk e ka mbrojtur me sukses punimin e masterit, ai mund të paraqesë propozim të ri të punimit të masterit brenda gjashtë muajsh prej ditës së njoftimit.

#### Neni 41

1. Kandidati që e mbron me sukses temën e masterit i lëshohet diploma sipas dispozitave të paraqitura në programin e akredituar dhe dispozitat e tjera statutare.
2. Teza e masterit e mbrojtur me sukses, publikohet në ueb faqen e fakultetit më së largu një muaj pas mbrojtjes publike dhe fitimit të titullit.

#### Neni 42


1. Kandidatit mund t'i kontestohet dhe t'i merret grada master nëse konstatohet se punimi i masterit është plagjiaturë, kompilacion ose falsifikim.
2. Dyshimet për praktikën e plagjiaturës dhe praktikën e tjera jo etike në punimin e tezës mund të ngrihen nga secili individ brenda universitetit dhe jashtë tij.
3. Në rast dyshimi të bazuar, Këshilli i Fakultetit e propozon komisionin prej tre anëtarësh që t'i shqyrtojë dyshimet e paraqitura, lidhur me pronësinë autoriale dhe cilësinë e punimit të masterit.
4. Komisioni i ngritur nga Këshilli i Fakultetit i paraqet Këshillit raportin përfundimtar me përfundim të qartë dhe të argumentuar. Këshilli i Fakultetit e shqyrton raportin e Komisionit dhe, nëse konstaton dyshimet nga paragrafët e mësipërm të këtij neni, i propozon Senatit të UKZ-së marrjen e thirrjes së masterit.
5. Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan e merr vendimin përfundimtar për marrjen e thirrjes së masterit.

#### Neni 43

##### Dispozitat kalimtare

1. Kjo Rregullore me propozimin e Këshillit të Fakultetit miratohet nga Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan.
2. Për të gjitha çështjet e tjera, që nuk janë përfshirë në këtë Rregullore, do të zbatohen dispozitat e Statutit të UKZ-së dhe të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës.
3. Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati dhe nënshkrimit nga ana e rektorit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan.
4. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje mund të bëhen sipas procedurës me të cilën është miratuar.



  
Kryesuesi i Senatit  
Prof. Dr. Bajram Kosumi, Rektor